



Romina Shqypi

## Një e ardhme e shkëlqyer në sektorin TIK: ALMOOC ofron mundësi karriere në TI për të rejtat në Shqipëri

Teksa ka një prirje globale për të tërhequr më shumë femra në sektorin TI, ka ende shumë paragjykime ndaj inxhinierëve femra të programeve: shumë besojnë se TI është një profesion i synuar për meshkuj. “Ky mentalitet është tërësisht i gabuar,” pohon Romina Shqypi, një ish stazhiere e Kurseve të Hapura Masive Online në Shqipëri (ALMOOC) që tani punon për ALMOOC Cloud Zone (ACZ), misioni i së cilës është të prezantojë sa më shumë shqiptarë ndaj TI që të jetë e mundur.

## A bright future in the IT sector: ALMOOC provides IT career opportunities for young women in Albania

While there is a global trend to attract more women in the IT sector, there is still a lot of prejudice towards female software engineers: many believe that IT is an inherently male profession. “This mentality is totally wrong”, asserts Romina Shqypi, a former Albania Massive Open Online Courses (ALMOOC) trainee who now works for the ALMOOC Cloud Zone (ACZ) whose mission it is to introduce as many young Albanians as possible to IT.

ALMOOC është platforma e pare shqip me Kurse të Hapura Masive Online (MOOC) në Shqipëri. MOOC janë një prirje globale edukimi, ku ofrohen falas kurse për çdo temë. Kjo sjell një numër avantazhesh: MOOC ofrojnë kurse të nxitura nga kërkesa, janë me kosto të ulët, dhe ritmi i kursit përcaktohet vetëm nga studentët. Sidomos kurset TI janë shumë popullore mes përdoruesve të MOOC-ve, sepse lejon ata me pak përvojë të hyjnë në një shteg karriere fitimprurës.

ALMOOC is Albania's first Massive Open Online Course (MOOC). MOOCs are a global, educational trend, whereby courses on any subject are offered free of charge. This brings out several advantages: MOOCs offer demand-driven courses, come at a low cost, and the pace of the course is solely decided by the students. IT courses in particular are popular among MOOC users, as it allows IT novices to enter a highly lucrative career path.

ALMOOC trajton një pengesë kyçe në sektorin TI të Shqipërisë: mungesën e një force pune të kualifikuar TI me aftësi inxhinierike TI të përditësuara. Duke ofruar kurse për gjuhë programimi që kërkohen shumë nga kompanitë TI, ALMOOC i lejon përdoruesit të përfitojnë shprehi në TI me kosto të ulët dhe të përmirësojnë në mënyrë domethënëse konkurrueshmërinë e tyre në tregun e punës. Në fakt, synimi parësor i ALMOOC është të dallojë stazhierë të talentuar TI që mund të punësohen nga kompania e programeve Real Visualz, kompania amerikane e TI që zotërohet nga themeluesi i ALMOOC.

Avantazhi i madh i ALMOOC është që kurset janë të aksesueshme nga kudo – çka paraqet avantazh të veçantë për femrat. Mbi 42% nga 8,500 stazhierët e ALMOOC që kanë kryer kurse TI janë femra. “Ka shumë vende pune për femrat në sektorin TI, por shpesh iu mungon informacioni i saktë për karrierën në sektor dhe për pasojë nuk kanë aftësitë e duhura,” shpjegon Pasho Toska nga ALMOOC.

ALMOOC addresses a key bottleneck in Albania's IT sector: lack of a qualified IT workforce with up-to-date IT engineering skills. By offering courses on programming languages that are in high-demand by IT companies, ALMOOC allows its users to inexpensively acquire IT skills and significantly improve their competitiveness in the labour market. In fact, ALMOOC's primary goal is to spot talented IT trainees who can be hired by the software company Real Visualz, the American IT company owned by the ALMOOC founder.

The great advantage of ALMOOC is that courses are accesible from anywhere – which is particularly advantageous for women. More than 42% out of the 8,500 ALMOOC trainees who have completed IT courses are in fact female. “There are plenty of jobs for women in the IT sector, but they often lack accurate career information on the sector and therefore do not have the right skills”, explains Pasho Toska from ALMOOC.

“Po zmbropsim mitin se sektori TIK është veç për meshkuj.” Sidorela, anëtare e ALMOOC

“We are reversing the myth that the ICT sector is only for males.” Sidorela, ALMOOC staff member

Bashkë me kolegët e saj nga ALMOOC Cloud Zone, Romina përpiqet të ndryshojë pikërisht këtë. Udhëton nëpër vend për t'i prezantuar të rinjtë shqiptarë – dhe sidomos vajzat – me mundësi karriere në sektorin TI. Ekipi i Cloud Zone, për shembull, organizon mësimet për kodimin në shkollat të ndryshme kudo në Shqipëri.

“Nuk e imagjinoni dot se sa shumë vajza atje jashtë janë të interesuara në TI dhe kanë shtytësën të ndjekin kurset e kodimit të ALMOOC,” thotë Sidorela, një tjetër anëtare e ALMOOC Cloud Zone. Ngadalë, por në mënyrë të sigurt, ekipi i ALMOOC është duke sfiduar stereotipet për TI në Shqipëri: një vajzë çdo herë.

Together with her colleagues from ALMOOC Cloud Zone, Romina tries to change precisely that. She travels around the country to introduce young Albanians – and particularly girls – to career opportunities in the IT sector. The Cloud Zone team, for instance, organizes coding lessons in various schools all over Albania.

“You can’t imagine how many girls out there are interested in IT and are eager to attend ALMOOC coding courses”, says Sidorela, another ALMOOC Cloud Zone member. Slowly but surely the ALMOOC team is defying IT stereotypes in Albania: one girl at a time.

